



ОПШТИНА РАНИЛУГ - КОМУНА Е РАНИЛУГУТ - MUNICIPALITY OF RANILUG -
ПРИЈЕМНА КАМЦЕЛАРИЈА ЗУВА Е ПРАНЦИТ

Org. jed./№ org./Org. unit O.R

Вр. с./№ с./No. p./ №. /No. / 02-023/ 2019

Datum/Data/Date 28.02.2019

ОПШТИНА РАНИЛУГ - КОМУНА Е РАНИЛУГУТ

RREGULLORJA MBI NDARJEN E SUBVENCIONEVE

RANILLUG

Shkurt 2019

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika c, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokal nr. 03/L-040, nenit 30.6 të Ligjit për Financat e Vetëqeverisjes Lokale Nr. 03 / L-049, Nenit 17, Paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika c të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. Përgjegjësitë Nr. 03 / L-048, Rregullorja (MAPL) Nr.01 / 2016 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, me Rregulloren e MF-Nr.04 / 2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, të Statutit të Komunës së Ranillugut Nr. 02-154 / 2011 të datës 23.12.2011, Kuvendi Komunal i Ranillugut në seancën e dytë të rregullt të mbajtur më 28.02.2019 miratoi:

RREGULLORJA MBI NDARJEN E SUBVENCIONEVE

Neni 1.

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve në territorin e komunës së Ranillugut nga kodi i subvencioneve.
2. Dispozitat e kësaj Rregullore do të zbatohen nga autoritetet dhe organet komunale gjatë ndarjes së subvencioneve të shfrytëzuesve.

Neni 2.

Definicioni

1. Termat e përdorur në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Subvencionet** - ndihma financiare jo-kthyesë për individët dhe subjektet juridike, të transferuara për shfrytëzuesit në llogaritë rrjedhëse apo xhironlogari që kanë treguar nevojën për mbështetje financiare, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë rregullore se ndihma mund të jepet një herë në vit (me përjashtim të individëve në fushën e shëndetit dhe ndihmës sociale, fëmijës së tretë dhe çdo fëmijë tjetër pas tijë).
 - 1.2. **Pagesë jo kthyesë** - është njëanshëm kur nuk ka mallra dhe shërbime të cilat dalin si kompensim ose kundërvlerë për pagesë.
 - 1.3. **Shfrytëzuesi** - individët fizikë dhe juridik që marrin mjete nga kategoria e subvencioneve të planifikuara në buxhetin komunal dhe në pajtim me Ligjin për ndarjet e buxhetit.
 - 1.4. **Banor rezident** - personi që jeton dhe punon në komunën e Ranillugut dhe që ka dokumentacion të vlefshëm të Republikës së Kosovës.

